



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____/2019
Dt. 28.03.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. Pika (d), nenit 40 pika (J) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim ndër komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.28.03.2019, pas diskutimeve lidhur me pikën e 2-të të rendit të ditës: Themelimi i Nismës për Bashkëpunimin ndër Komunal me Komunën e Rahovecit, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet NISMA për Bashkëpunimin Ndër Komunal në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Rahovecit .
2. Bashkëpunimin Ndër Komunal në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Rahovecit, do të bëhet në fushën e Infrastrukturës për projektin e Pendës së Drinit të Bardhë nga fondi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që ti filloj Konsultimet dhe përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për bashkëpunim Ndër Komunal.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

5. Vendimi iu dërgohet:

- Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
Anton Shala
Anton Shala